




---

# RAPORTI I SHSTATË I MONITORIMIT TË CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN

---



## KUVENDI NËN THJERRËZ

Përforcimi i debatit politik  
dhe diskursit deliberativ

SHKURT 2015



## **RAPORTI I SHTATË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN (SHKURT 2015)**

Instituti për demokraci "Societas Civilis" – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin nivelin e cilësisë së debatit në Kuvendin dhe raportimin e medieve nga puna e deputetëve. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit "Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ" financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian. Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik. Para jush është raporti i SHTATË i tillë i cili ka të bëjë me debatin kuvendor në muajin shkurt të vitit 2015.

Me aplikimin e "Indeksit për cilësi të debatit"<sup>1</sup> sipas disa parametrave vlerësohet çdo fjalim i veçantë i pjesëmarrësve në seancat plenare dhe seancat e tetë komisioneve kuvendore të përzgjedhura sipas rëndësisë së tyre për debatin politik dhe kulturën politike në shtetin.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike, të fitohen njohuri se sa janë të argumentuara diskutimet në shtëpinë ligjvënëse dhe se sa qëndrimet e ndryshme merren parasysh dhe kontribuojnë në krijimin e ligjeve.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit realizohet edhe monitorimi i disa medimeve kombëtare<sup>2</sup> për tu parë se në çfarë mase opinioni është i njoftuar me esencën e debateve kuvendore dhe me përmbajtjen e argumenteve të shfaqura në seancat nga ana e deputetëve.

Pas çdo muaji të monitoruar opinioni do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe nga monitorimi i debatit në Kuvendin dhe të informimit mediatik.

---

<sup>1</sup> Indeksi për cilësi të debatit (Discourse Quality Index) është i krijuar nga një grup i teoricienëve prijës botëror demokracisë deliberative (debatuese). Indeksi paraqet metodologji e cila mundëson hulumtim empirik të cilësisë së debateve, forma dhe përmbajtja e të cilave, sipas teoricienëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë në një shoqëri. Indeksi gjatë viteve të fundit është përdorur për hulumtim të debatit në Parlamentin Evropian edhe në parlamentet e Gjermanisë, Zvicrës dhe në Kongresin amerikan.

<sup>2</sup> Monitorimi i medieve i përfshin televizionet kombëtare Sitel, Tellma, Alsat-M dhe RTM2 në gjuhën shqipe dhe gazetatat Dnevnik, Sloboden pečat, Utrinski vesnik, Večer, Koha dhe Lajm.

Projekt: Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ.

Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



## A. REZYME

Deputetët në shkurt më së paku deri i arsyetonin pozitën e veta me nga dy dhe më tepër argumente, e më shpesh nga fillimi i monitorimit kanë diskutime në të cilat arsyetimi të cilat arsyetimi ishte i dobët përkatësisht i pamjaftueshëm për tu llogaritur për një argument të plotë.

Në këtë periudhë ata sërish nuk arritën të ç'binden në rregullshmërinë e argumenteve të veta dhe çdokush mbeti në "istikamin" e vet. Është vërejtur vetëm një rast kur deputeti e ka ndryshuar pozitën e vet, por nuk ka dhënë arsyetim për të cilat shkaqe e bënë atë. Nuk është vërejtur rast që deputeti ta ndryshojë pozitën për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin.

Karakteristikë për shkurtin është se në seancat e monitoruara deputet femra ishin në mënyrë të konsiderueshme më aktive se sa burrat. Në ato shkojnë madje 57% nga të gjitha diskutimet e monitoruara. Në deputetet femra shkojnë pjesa dominante e replikave dhe kundër-replikave.

Është shtuar shprehja e respektimit ndaj argumenteve të folësve të tjerë, është zvogëluar shfaqja e respektimit ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancat, ndërsa në dy raste është vërejtur përdorimi i fjalorit të pahijshëm ndaj personave të tjerë të pranishëm të seancave.

Deputetët në shkurt më së shumti diskutuan rreth pyetjeve të deputetëve, propozim Ligjit për transformim në marrëdhënie të rregullt pune, ndryshimet e Ligjit për arsim të lartë, për Ligjin për komunikime elektronike dhe për Ligjin për drejtorinë doganore.

Opozita në shkurt e përfaqësuar prej 10 deputetë e pati deri tani pjesëmarrjen më të lartë në diskutimet me 29% nga të cilat paraprakisht e arritën në janar.

Një pjesë e madhe të pikave të rendit të ditës kaluan me diskutim të pakët dhe të njëanshëm ose pa kurrfarë diskutimi.

Me tërë këtë qëndron konkluzioni se opinioni sërish mbeti më i varfër për debat cilësor për një pjesë të zgjidhjeve ligjore. Në këtë mënyrë është lëshuar mundësia që përmes diskutimit të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të shfaqura të deputetëve, si dhe mundësia që ato të kontestohen ose plotësohen, gjë e cila do të kontribuojë për sjellje të ligjeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

## B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

"Indeksi i cilësisë së debatit" mundëson që çdo debat i veçantë i shfaqur në seancat të kodifikohet sipas disa karakteristikave kryesore:



- shkalla e argumentimit të fjalimit<sup>3</sup>;
- shkalla i respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- çiltërsia për praninë të argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të veta nën fuqinë e argumenteve të prezantuara në debatin;
- nëse deputetët arsyetojnë se në emër të kujt dhe interesat e kujt i prezantojnë qëndrimet e veta;
- nëse deputetët mund pa pengesa të shfaqin qëndrimet e veta dhe
- në çfarë mase është i pranishëm fjalori i pahijshëm.

Me monitorimin janë përfshirë debatet në trupat vijuese punuese në Kuvend:

- Seanca plenare;
- Komisioni për çështje kushtetuese;
- Komisioni për financa dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;
- Komisioni për zgjedhje dhe emërimet;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni anketues për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni ligjvënës juridik.

## V. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (OBMR-PDUK ose VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin ata e themeluan qeverinë, Bashkimi demokratik për integrim (BDI ose DUI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë të Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (NDP). Deputeti i cili mandatin e morri nga RDK edhe përkundër vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin ju bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë tani grupi parlamentar i BDI-së numëron 20 deputetë.

<sup>3</sup>Nën shkallë të argumentimit merren parasysh numri i argumenteve me të cilat deputeti në fjalimin e tij i arsyeton pozicionet e veta duke mos hyrë me këtë rast në vërtetësinë ose vlefshmërinë e argumenteve. Me këtë rast nuk merren parasysh argumentet të cilat në mënyrë të qartë dhe pa dyshim janë nga tema e debatit.



Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e raportit të parë, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM ose SDSM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotojnë punën e Kuvendit<sup>4</sup>. Në muajin shkurt në Kuvendin si opozitë vepronin tre deputetë nga koalicionin opozitar të LSDM të cilët vendosën që ti pranojnë mandatet dhe shtatë deputetë të Partisë demokratike shqiptare (PDSH) dhe tre deputetë nga koalicioni opozitar të LSDM të cilët vendosën që ti pranojnë mandatet. Shumica në Kuvendin në nëntor e filluan procedurën për marrje të mandateve të 31 deputeti opozitar të cilët e bojkotojnë parlamentin. Procedura, deri në publikimin e këtij raporti ende nuk ka përfunduar. Kah fundi i janarit, Zoran Zaev, lideri i LSDM-së në pres-konferenca filloi ti shpalojë të ashtuquajturat “bomba” përkatësisht audio incizimet e bisedave kinse të përgjuara të funksionarëve të lartë shtetëror. Zaev nga policia është i dyshuar për dhunë ndaj organeve shtetërore, rrezikim të rendit kushtetues dhe të institucioneve demokratike. Në të njëjtën kohë, anëtarët e opozitës Prokurorisë publike i dorëzuan disa padi penale në sajë të informacioneve të cilat burojnë nga audio incizimet të cilat i publikon. Zhvillimi i këtillë i ngjarjeve edhe më tepër e thellon krizën e thellë politike e cila filloi me mos-njohjen e procesit zgjedhor dhe bojkotin e Kuvendit nga opozita.


## G. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport e përfshin debatin në Kuvend në periudhën nga 1 deri më 28 shkurt të vitit 2015. Janë analizuar gjithsej 296 fjalime të pjesëmarrësve të debateve në gjithsej 9 seanca nga të cilat 5 janë plenare dhe 4 janë të trupave punuese. Nga seancat e trupave punuese janë përcjellë nga një seancë e Komisionit për çështje kushtetuese, Komisionit për sistem politik dhe raporte midis bashkësive, Komisionit për financim dhe buxhet dhe Komisionit ligjdhënës-juridik. Me këtë rast, në seancën e Komisionit Ligjdhënës-juridik të mbajtur më 11 shkurt në shtatë pika të rendit të ditës asnjë deputet nuk e morri fjalën.

Nga numri i tërësishëm i fjalimeve të monitoruara, 218 janë të deputetëve në Kuvendin, ndërsa 79 të pjesëmarrësve të jashtëm si ministra, përfaqësues të ministrive, institucione të tjera shtetërore dhe publike. Ky raport ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.


---

<sup>4</sup>Deputetët opozitare Roza Topuzovska Ka revska nga Partia Li berale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.




#### Në raport me karakteristikat demografike të deputetëve që kanë folur, sipas:


- Seksit 57% janë gra, ndërsa 43% burra.
- Përkatësisë etnike: 91% janë Maqedonas etnik, 7% Shqiptarë etnik, 2% janë të tjerë.
- Arsimimit: 2% janë me arsimim të mesëm, 59% janë me arsim të lartë, 27% magjistra 12% doktorë të shkencave.
- Në sajë të njësive zgjedhore: Më aktiv ishin deputetët nga njësia e katërt zgjedhore (28%), ndërsa më pak diskutime kishin deputetët nga njësia e gjashtë zgjedhore (6%).




Në shkurt deputetët opozitar në seancat e monitoruara e ruajtjen pjesëmarrjen në diskutimet prej 29% gjë e cila është njëlloj si në janar. Kjo në të njëjtën kohë është pjesë, marrja më e lartë e opozitës të cilën e përbëjnë 10 deputetë që nga fillimi i monitorimit në qershor të vitit të kaluar.




Në seancat e monitoruara në shkurt deputet gra ishin më aktive në mënyrë të konsiderueshme se kolegët e tyre burra. Në deputetet shkojnë 57% të diskutimeve të tërësishme gjë e cila është pjesëmarrje më e lartë që nga fillimi i monitorimit. Me këtë rast, duhet marrë parasysh se deputetet gra janë 35% nga numri i tërësishëm i deputetëve në përbërjen aktuale të Kuvendit. Nga kjo rezulton se gratë në mënyrë të konsiderueshme më shpesh e kanë marrë fjalë se sa burrat.



Nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet sipas seksit të deputetëve të cilët e kanë marrë fjalën në seancat e monitoruara rezulton se çdo diskutim i deputetëve burra dhe gra ka zgjatur mesatarisht nga 3 minuta.




Sipas pjesëmarrjes, nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet në numrin e tërësishëm të mandateve të pranura rezulton se mesatarisht çdo deputet nga shumica (82 deputetë) ka folur nga 6, ndërsa çdo deputet nga opozita (10 deputetë) ka folur nga 22 minuta. Nëse koha e tërësishme e diskutimeve pjesëtohet vetëm në deputetët të cilat e kanë marrë fjalën në seancat e monitoruara rezulton se çdo diskutim i bërë nga deputetët opozitar mesatarisht ka zgjatur nga 4 minuta, ndërsa nga deputetët e shumicës mesatarisht nga 3 minuta.




## I. LLOJE TË FJALIMEVE DHE INTERAKSIONI

Monitorimi në shkurt tregoi interaksion pothuajse identik midis deputetëve vëzhguar sipas numrit të replikave dhe kundër-replikave midis pjesëmarrësve në debatet krahasuar me muajin paraprak. Me këtë rast, si replika dhe kundër-replika janë vërejtur edhe pyetjet dhe përgjigjet midis deputetëve dhe ministrave në seancën plenare që u kushtohet pyetjeve të deputetëve. Nga seancat e monitoruara në diskutime individuale shkojnë 66%, në replika 14%, ndërsa në kundër-replika 20% të diskutimeve. Kjo vë në pah zvogëlimin e replikave për 2% dhe në llogari të asaj rritje e kundër-replikave për 2%. Nëse shihet e tërë periudha nga fillimi i monitorimit, përqindja e kundër-replikave në shkurt ka arritur nivel më të lartë.





Në seancat e monitoruara deputetët burra kanë dhënë 50% të diskutimeve individuale, 39% të replikave dhe 25% nga kundër-replikat. Deputetet gra, ndërkaq, kanë dhënë 50% të diskutimeve individuale, 61% nga replikat dhe 75% nga kundër-replikat.




## II. SHKALLË E ARGUMENTIMIT TË FJALIMIT

Nga fjalimet e monitoruara të deputetëve sipas Indeksit për cilësi të debatit, në shkurt vazhdoi trendi i rënies së numrit të diskutimeve në të cilat diskutuesit pozitat dhe qëndrimet e veta i mbrojnë me dy dhe më tepër argumente dhe e arriti nivelin më të ulët që nga fillimi i monitorimit. Njëkohësisht, përqindje më të lartë që nga fillimi i monitorimit arritën diskutimet në të cilat argumentimi ka qenë i dobët përkatësisht arsytimi që e ka dhënë diskutuesi nuk mjafton që të konsiderohet si një argument i tërësishëm.

Në shkurt në 37% ekziston arsytim të pozicioneve me dy ose më tepër argumente. Në 44% të diskutimeve deputetët i kanë arsyetuar pozicionet e veta me një argument. Në 17% argumentimi ka qenë i dobët. Në 2% nuk është prezantuar kurrfarë argumenti në diskutimin. Marrë në përgjithësi, në shkurt shkalla e argumentimit me më së paku dy argumente është më e ulët deri që nga fillimi i monitorimit (qershor i vitit 2014).



Sa për krahasim, në periudhën e parë të monitoruar nga 19 qershori deri më 1 gusht në 72% të diskutimeve janë të vendosur nga 2 dhe më tepër argumente, ndërsa në 7% arsyetimi ka qenë i dobët.




### III. FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në seancat e monitoruara në shkurt, si dhe në periudhat paraprake, asnjë folës nuk është paraqitur me një pozitë që mandej të vë në pah se e ndërron pozitën për shkak të argumenteve më të mira e prezantuara në debatin nga diskutuesit të tjerë. Në një rast është vërejtur se një deputet në seancën e Komisionit për financim dhe buxhet ka vënë në pah ndryshimin e pozicionit, por ai me këtë rast nuk ka vënë në pah përse e ndryshon. Ndryshimi i pozicionit për shkak të argumenteve më cilësore është vërejtur vetëm në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 1 gusht 2014).


Në shkurt në 37% të diskutimeve folësit e kanë njohur vlefshmërinë e argumenteve të diskutuesve të tjerë. Kjo vë në pah se një pjesë e folësve në seancat kanë pasur pozita të njëjta me pjesëmarrësit tjerë në debatet dhe kanë shfaqur respektim të argumenteve të tyre. Një pjesë tjetër e folësve kanë pasur pozita të ndryshme, por kanë shfaqur respekt dhe e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të kundërshtuara të prezantuara nga bashkëbiseduesit. Mirëpo, njohja e vlerës së argumenteve të huaja në asnjë rast nuk ka sjellë në ndryshim të pozitave të folësve. Njëkohësisht ky është niveli më i lartë i kësaj kategorie që nga fillimi i monitorimit.

Në 15% folësit nuk e kanë njohur vlefshmërinë e argumenteve të prezantuara nga pjesëmarrësit e tjerë, e as e kanë ndryshuar pozitën e vet. Në 47% të diskutimeve folësit aspak nuk i kanë vështuar argumentet e shfaqura nga pjesëmarrësit e tjerë në seancat.




#### IV. RESPEKTIM NDAJ Pjesëmarrësve

Në shkurt deputetët në 46% të diskutimeve kanë shfaqur respektim ndaj deputetëve të tjerë, bashkëpjesëmarrës në seancat. Kjo është zvogëlim për 13% në raport me janarin, por për 18% më tepër se sa në dhjetor. Në 35% të diskutimeve folësit nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj pjesëmarrësve të tjerë. Shkalla e respektimit të pjesshëm është rritur në 14% gjë e cila është 10% më tepër se sa në janar dhe 5% se sa në dhjetor. Respektimi i pjesshëm do të thotë se diskutuesit në pjesën më të madhe të të diskutimeve të veta kanë qenë neutral ose kanë shfaqur respektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë, por në një pj4esë të vogël kanë drejtuar sulme dhe fyerje edhe personale edhe partiake. Respektimi eksplicit, para së gjithash do të thotë se deputetët në diskutimet e veta kanë drejtuar lëndata personale ose partiake ndaj pjesëmarrësve të tjerë në seancat. Në shkurt në seancën e dedikuar pyetjeve të deputetëve është vërejtur një rast i mos-respektimit të plotë ndaj pjesëmarrësve të tjerë dhe një rast i mos-respektimit të pjesshëm.



## V. RESPEKTIM NDAJ ARGUMENTEVE

Në shkurt deputetët në masë më të madhe kanë shfaqur respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Atë e bënë në 59% të diskutimeve që krahasuar me janarin është për 3% më tepër. Prapëseprapë, ky nuk është niveli më i lartë. Në periudhën 19 qershor – 1 gusht të vitit 2014 deputetët kanë treguar respektim ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë në 74%, ndërsa në periudhën 25 gusht – 30 shtator të vitit 2014 në 61% të diskutimeve. Në dhjetor, ndërkaq, deputetët kanë treguar më pak respektim përkatësisht vetëm në 8% të rasteve. Në 10% të diskutimeve folësit kanë treguar respektim të pjesshëm. Kjo do të thotë se në pjesën më të madhe të diskutimeve janë neutral ose shfaqin respektim, por në pjesë më të vogël shfaqin mos-respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë.






## VI. VËLLIMI I ARSYETIMEVE DHE I NDËRPRERJEVE

Në shkurt deputetët në 34% të fjalimeve, pjesëmarrësit kanë qenë neutral përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet e veta me përfitime ose pasoja për ndonjë grup ose parti. Në 41% të diskutimeve deputetët i ndërlidhën argumentet e veta me përfitime ose pasoja për të mirën e të gjithë qytetarëve përkatësisht me të mirën e përgjithshme. Kjo është për 11% më pak se sa në janar. Në 20% të diskutimeve folësit i ndërlidhin argumentet e veta me përfitime ose pasoja për grupe të tjera përkatësisht para së gjithash me grupe të ndryshme sociale në shoqërinë. Deputetët në shkurt shumë më pak i ndërlidhin argumentet me përfitime ose pasoja për grupet e veta etnike ose grupe politike krahasuar me muajt paraprak. Monitorimi në shkurt tregoi rënie të përqindjes së përfitimeve ose pasojave për grupet e veta partiake ose etnike.

Në një rast është vërejtur ndërprerje e diskutimit të një diskutuesi nga pjesëmarrësit e tjerë të seancës. Pas ndërprerjes së shkurtër, diskutuesi e ka vazhduar diskutimin e vet.



## VII. GJUHA E PAHIJSHME

Në pikëpamje të gjuhës së pahijshme, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara kuvendore në këtë periudhë në përgjithësi përmbaheshin nga përdorimi i saj. Në shkurt janë vërejtur dy raste kur deputetët kanë përdorur gjuhë të pahijshme ndaj personave të tjerë pjesëmarrës në seancat. Dy diskutime në të cilat është përdorur gjuhë e tillë ndodhën në seancën të dedikuar pyetjeve të deputetëve. Nuk është vërejtur rast i kufizimit të deputetëve gjatë fjalimeve të tyre nga foltoret.

### D. KONKLUZIONE:

- Vazhdoi trendi i zvogëlimit të diskutimeve në të cilat deputetët qëndrimet i mbështesin me nga dy dhe më tepër argumente, ndërsa u rrit përqindja e diskutimeve me arsyetim të dobët.

Projekt: Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ.  
Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



Shkalla e argumentimit të më së paku dy argumente në shkurt ka rënë në nivelin më të ulët që nga fillimi i monitorimit.

- Pjesëmarrësit në seancat e monitoruara sërish nuk shfaqën interes dhe gatishmëri për ndryshimin e qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të shfaqura në debatin .Asnjë deputet nuk ka vënë në pah ndërrimin e pozitës së vet edhe pse në 37% nga rastet folësit e kanë njohur vlefshmërinë e argumenteve të prezantuara nga pjesëmarrësit e tjerë në seancat. Në një rast deputeti e ka ndryshuar pozitën e vet, por nuk ka arsyetuar për cilat shkaqe e bën atë.
- Vazhdoi trendi i zvogëlimit të përqindjes së diskutimeve në të cilat folësit aspak nuk i vështrojnë argumentet e shfaqura nga folësit e tjerë. Në nëntor ishte 99%, në dhjetor 83%, në janar 50%, ndërsa në shkurt 47%.
- Opozita në Kuvendin e përfaqësuar nga 10 deputetë e ruajti pjesëmarrjen në diskutimet prej 29% në mënyrë identike si edhe në janar. Njëkohësisht ky është edhe niveli më i lartë i deputetëve opozitar që nga fillimi i monitorimit në qershor të vitit 2014 e deri tani .
- Në shkurt është monitoruar seanca e Komisionit ligjdhënës-juridik në të cilën për 7 pika të rendit të ditës asnjë deputetët nuk ka marrë fjalë.
- Sipas seksit të diskutuesve deputetët kanë qenë në mënyrë të konsiderueshme më aktive se sa deputetët. Në deputetët shkojnë 57% nga numri i tërësishëm i diskutimeve, ndërsa te burrat 43%. Të gratë shkon pjesa dominante e replikave dhe kundër-replikave.
- Në shkurt sërish u rrit përqindja e diskutimeve në të cilat deputetët kanë shfaqur respektim ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë, ndërsa për 13% u zvogëluan diskutimet në të cilat u shfaq respekt ndaj vetë pjesëmarrësve të seancave. Në një rast është shfaqur mos-respektim i plotë ndaj një pjesëmarrësi në seancën plenare, ndërsa në një rast është përdorur edhe gjuhë e pahijshme ndaj personalitetit të një nga pjesëmarrësve .
- Pyetjet e deputetëve, propozimi i Ligjit për transformim në marrëdhënie të rregullt pune, ndryshimet e Ligjit për arsim të lartë, të Ligjit për komunikime elektronike dhe të ligjit për drejtori doganore nxiti më shumë debat midis deputetëve .
- Është rritur përqindja e diskutimeve në të cilat folësit janë neutral, përkatësisht nuk i ndërlidhin argumentet e prezantuara me përfitimet dhe pasojat për asnjë grup, dhe kjo është në nivel më të lartë deri tani prej 34%. Për llogari të kësaj, deputetët në shkurt më rrallë argumentet e veta i ndërlidhin me të mirën e përgjithshme krahasuar me janarin. Për llogari të kësaj deputetët në shkurt më shpesh i ndërlidhin argumentet e veta me përfitime ose pasoja për grupe të tjera – 20%, me këtë rast më shpesh me grupe të ndryshme sociale në shoqërinë. Është zvogëluar përqindja e diskutimeve në të cilat folësit thirren në përfitimet ose pasojat e grupeve të veta politike ose etnike .
- Diskutimi rreth pjesës më të madhe të propozimeve ligjore mbetet në përgjithësi i dobët dhe nuk mundëson që përmes debatit publik të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të përgatitura dhe të prezantuara të deputetëve. Me atë humbet mundësia që



argumentet të kontestohen ose të plotësohen, e me atë opinioni është i varfëruar për pikëpamje të ndryshme të cilat do të kontribuonin për përpilim të vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

\*\*\*\*\*

- Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.
- Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.